



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 30 korrik 2014, në mbledhjen e VIII-të
(tetë) të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.15'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht Afrim Shabani, Bahri Blakçori, z. Islam Revuçi Fidan Rekaliu, Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahau – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe z. Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, z. Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe z. Muharrem Haziri, përfaqësues i OSBE-së.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, kryesues, propozoi që në rend dite të përfshihen edhe:

- Propozimi i vendimit për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore sipas kërkesës së Muharrem Isufit nga fshati Majac, në kuadër të pikës së gjashtë të rendit të propozuar të ditës, kërkesë e cila ka arritur para dërgimit të thirrjes dhe materialit për këtë mbledhje, dhe
- Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 01-119-61160, datë 13 korrik 2014, për kompensimin e punëve dhe angazhimeve të Komisionit për propozimin e emërtimeve të zonave, lagjeve urbane, shesheve, parqeve, rrugëve dhe rrugicave në territorin e Komunës së Podujevës, për shkak se në procesin e votimit kanë votuar edhe këshilltarët të cilët janë njëkohësisht edhe anëtarë të Komisionit të cekur, e që një veprim i tillë është në konflikt interesi.

z. Naim Çunaku, theksoi, në proces e sipër është dhënia me qira e paluajtshmërive në pronësi të Komunës, prej momentit të hapjes së ofertave, afati i ushtrimit të ankesave është 30 ditë dhe nëse parashtrohet ndonjë ankesë sigurisht se do të tejkalohet afati i përcaktuar me dispozita ligjore. Duke u bazuar në këtë, propozimi im është që edhe kjo çështje të përfshihet në rend dite, këtë çështje e ngrita ngase e konsideroj si të nevojshme mirëpo mbetet në vullnetin e këtij Komiteti se çfarë do të vendos.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, e mbështeti propozimin e parafolësit.

z. Kadri Avdiu, theksoi, e kam një kërkesë të cilën në vazhdimësi e kemi shtruar në mbledhjet e këtij Komiteti por edhe në mbledhje të Kuvendit e ajo ka të bëjë me dhënien e sqarimit lidhur me lokacionin për ndërtimin e obeliskut të Heroit Afrim Zhitia, përkatësisht përse kjo çështje nuk shtrohet për shqyrtim edhe pse proceduara për konstatimin e uzurpimeve ka përfunduar në Drejtorinë e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë. Këtë çështje e ngriti ngase me këtë vonesë po rrezikohet donacioni prej 500.000 €.

Gjithashtu në rend dite do duhej të përfshihet edhe çështja e fillimit të ndërtimit të shkollës në fshatin Batllavë, meqë jam i informuar se atje është paraqitur një problem për të cilin konsideroj se do duhej të debatohet.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, lidhur me çështjen e lokacionit të obeliskut të Heroit Afrim Zhitia, jam interesuar dhe jam informuar se kërkesa e Ministrisë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i është drejtuar Ekzekutivit të Komunës mirëpo pasi që kjo çështje është ngritur disa herë në Kuvend, ju njoftoj se Agjencioni Kadastral i Kosovës ka vendosur lidhur me ankesat e ushtruara ndaj vendimeve të Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë dhe atë në favor të Komunës, mirëpo palët e kanë hapur kontestin administrativ në Gjykatë, andaj ne si Komitet për Politikë dhe Financa përkatësisht si Kuvend nuk mund ta shqyrtojmë këtë çështje pa u propozuar materiali përkatës nga Ekzekutivi.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit, me 6 vota për, 4 kundër dhe 1 votë të përmbajtur, i rekomandohet që në rend dite për mbledhjen e datës 31 korrik 2014 të përfshihen edhe:

- Propozimi i vendimit për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore sipas kërkesës së Muharrem Isufit nga fshati Majac, në kuadër të pikës së gjashtë të rendit të propozuar të ditës
- Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 01-119-61160, datë 18 korrik 2014, për kompensimin e punëve dhe angazhimeve të Komisionit për propozimin e emërtimeve të zonave, lagjeve urbane, shesheve, parqeve, rrugëve dhe rrugicave në territorin e Komunës së Podujevës*
- Propozimi i vendimit për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim.

2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e KPF – së më 26 maj 2014

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2013

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën e hyrjes.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, në bazë të materialit i cili na është dërguar, Raporti i Auditimit është shqetësues për arsye se sipas paraqitjes së Auditorit, asnjë rekomandim i auditivit të kaluar nuk është përmirësuar në vitin pasues nga Ekzekutivi i Komunës. Një prej pikave më shqetësuese, sipas mendimit tim, është pika e parafundit e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm është, shtimi i kontrollit tek procesi i prokurimit duke respektuar kriteret e tenderimit në mënyrë që të mos shpërblehen ofertuesit e papërgjegjshëm, pastaj thuhet, të vazhdohet me procesin e regjistrimit të të gjitha pasurive dhe të hartohet regjistri përfundimtar i cili më pas do të azhurnohet në baza të vazhdueshme, e për këtë të fundit është mbledhja e katërt që kam kërkuar në mënyrë zyrtare që Administrata të na e sjell regjistrin e pasurive të Komunës, dhe nëse nuk silllet edhe në mbledhjen e radhës, do të bëjë kërkesë personale që së paku unë në cilësinë e këshilltarit të Kuvendit ta kem atë regjistrë.

Auditori ka gjetur se rrugë dhe rrjete kanalizimi në vlerë prej 416.407 € nuk janë të evidentuara në regjistrin kontabël dhe nuk janë të prezantuara në pasqyrat financiare. Gjithashtu se Komuna e ka bërë klasifikimin e gabuar të shpenzimeve ku nga kategoria e investimeve kapitale ka paguar për mallra dhe shërbime në vlerë prej 88.104 €, për këtë kërkoj sqarime nga drejtori i Drejtorisë së Buxhetit.

Te adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak ka rezultuar me 15 rekomandime kryesore shqetësuese është se ngase menaxhmenti nuk ka arritur t'i adresojë të gjitha rekomandimet, pra vetëm një pjesë e tyre janë marrë parasysh por pjesa dërmuese nuk janë marrë parasysh, që do të thotë se të njëjtat probleme kanë vazhduar edhe në vitin 2013.

Sa i përket raportimeve tek menaxhmenti i lartë, Auditori e ka gjetur një të metë se raportimet tek Kryetari i Komunës, për punët dhe aktivitetet e kryera, nuk kanë qenë të rregullta nga Drejtoritë përkatëse.

Problem tjetër është se në asnjë vit nuk janë shpenzuar në tërësi të hyrat vetanake, në këtë kontekst jemi në dijeni se në vitin 2014, nga viti paraprak, janë bartur 188.000 €.

Çdo vit kemi rënie të të hyrave vetanake, në këtë vit janë 13% më të ulëta e kjo sipas mendimit tim është shqetësuese.

Problem tjetër i cili më ka bërë përshtypje është mosrespektimi i kriterëve të vendosura në dosje të tenderit, në këtë kontest të gjithë jemi në dijeni se ka qenë në media se zyrtari i prokurimit nuk e ka diplomën universitare e dihet se zyrtarët e prokurimit duhet ta kenë edhe licencimin e posaçëm, nuk dyshoj që këtë nuk e ka mirëpo te kontrata e asfaltimit të rrugës Halabak – Tërnavë, që e kemi cekur në mbledhje të Kuvendit, në vlerë 130.825 € në dosjen e tenderit ka qenë që Operatori Ekonomik të ketë listën e punëtorëve të vulosur dhe nënshkruar në Administratën Tatimore për vitin 2013, mirëpo operatori përkatës nuk e ka sjellë këtë dëshmi.

Çështja tjetër te asfaltimi i rrugëve të qytetit, në vlerë prej 866.068 € kriter i përcaktuar në dosje të tenderit ka qenë që operatori ta sjellë vërtetimin e tatimit në

pronë, mirëpo kompania përkatëse e ka sjellë vërtetimin e tatimit në pronë të një kompanie tjetër, kjo është shkelje ligjore dhe duhet të merren masa të drejtpërdrejta ndaj zyrtarit që e ka pranuar atë vërtetim. Po ashtu në këtë rast është bërë shkelje edhe me tejkalimin e limitit për punë të nënkontraktuara e që është 40%.

Konsideroj se Drejtoritë e Komunës duhet t'i koordinojnë punët në mënyrë që pagesat të bëhen me rregull ngase kjo është akti final i realizimit të projekteve.

Do ta përfundoj me këtë se në çdo flet të këtij raporti ka shkelje të dokumentuara e unë gjatë diskutimit i përmenda vetëm disa prej tyre.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, ekzekutivi të dhënat përkatëse i ka paraqitur në materialin për të cilin jemi duke debatuar, e drejtë e çdo anëtar i këtij Komiteti është të paraqes mendimin e vet, mirëpo sugjerimi im është që çështjet të cilat i paraqiti z. Rafet Llapashtica të mos përsëriten.

z. Haki Rudari, theksoi, duke u bazuar në këtë material që në fillim kam vërejtur realitetin e shpenzimeve të buxhetit si në aspektin pozitiv ashtu edhe atë negativ, vërejtjet e mia konsistojnë në të gjeturat e Auditorit që në mes të tjerash janë që : regjistri i pasurive fikse ende nuk është i plotë dhe i saktë për arsye se janë identifikuar rrugë dhe rrjetë të kanalizimeve në vlerë prej 416.407 € që nuk janë evidentuar në regjistër dhe nuk janë prezantuar në pasqyrat financiare, vërejtje e cila është mjaftë serioze.

Në material thuhet se nga kategoria e investimeve kapitale janë paguar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve 88.104 €, edhe kjo çështje nuk duhet të nënçmohet.

Vërejtjet në vijim janë se nuk janë marrë në konsideratë vërejtjet e auditorit të paraqitura në raportin e vitit paraprak se rekomandimet për respektimin e afateve nuk janë marrë parasysh, rezultojnë me kontrole të dobëta, pastaj me humbje të potencialeve financiare të vazhdueshme. Vërejtje tjetër është ku thuhet se Njësia e auditimit të brendshëm ka përmbushur pjesërisht planin e punës. Auditori ka gjetur shkelje dhe ka bërë vërejtje edhe në prokurim ku janë bërë shumë vërejtje madje thuhet se janë lidhur kontrata me Operator Ekonomik të papërgjegjshëm. Ka pasur klasifikime të gabuara të shpenzimeve dhe menaxhim të dobët të pronave.

Gjithashtu, sipas Raportit, vërehet rënie e arkëtimit të të hyrave vetanake, madje jepen edhe udhëzimet për ngritjen e shkallës së arkëtimit të të hyrave vetanake.

Vërejtje paraqiten edhe në aspektin e arkëtimit të qirasë për shfrytëzimin e paluajtshmërive në pronësi të Komunës.

Pajtohem me kolegün i cili kërkoi regjistrin e pasurive të Komunës dhe konsideroj se atë regjistër do duhej ta kishin të gjithë këshilltarët e Kuvendi.

z. Naim Çunaku, theksoi, drejtori z. Isuf Latifi, në falën hyrëse, tha se Auditori ka shprehur falënderime, unë konsideroj se falënderimet për raporte njerëzore, korrekte dhe në këtë rast i përgëzoj përfaqësuesit e Komunës për nikoqirllëkun dhe pritjen e mirë të Auditorit. Ndërsa sa i përket raportit, kësaj radhe e kemi një raport që disa segmente i ka me theks të veçantë, pra ka vu aksent te disa çështje të cilat e rëndojnë Komunën tonë në vazhdimësi.

Një element të cilin kolegët nuk e përmenden është që Komune jonë është një prej dhjetë Komunave që ka hyrë në obligime te Operatorët Ekonomik dhe ka obligime të pashlyera, pra kjo duhet të jetë shqetësuese për menaxherët e parasë publike.

Element tjetër të cilin në vazhdimësi e kemi potencuar, të paktën unë disa herë e kam potencuar, është se ne fillojmë dhe e përfundojmë një vit buxhetor, edhe pse dispozitat ligjore dhe Rregulloret përcaktojnë se Zyra e prokurimit duhet ta ketë Planin vjetor të prokurimit ajo prej sa unë jam këshilltar i Kuvendit asnjëherë nuk e ka paraqitur planin e cekur dhe nga kjo na del se në një fazë të caktuar bëhet grumbullimi i shumë punëve e me këtë dhe rrezikimi i mos shpenzimit të buxhetit por edhe përpjekjet për shpenzimin e buxhetit për një afat të shkurtë kohor duke bërë shkelje çfarë i potencuan parafolësit.

Në të gjitha raportet e Auditorit të përgjithshëm në vazhdimësi kemi pasur theks të veçantë të Auditimi i brendshëm, edhe kësaj radhe nuk mungon se Auditimi i brendshëm ka ngecje.

Me rastin e shqyrtimit të Raportit financiar për vitin 2013 ka pasur diskutime për atë se janë bërë pagesa prej një kodi në një kod tjetër, këtë e ka gjetur dhe konstatuar edhe Auditori.

Krejtësisht në fund, habitem dhe nuk mundem ta kuptojë përse Komuna jonë nuk mundet të realizojë arkëtimin e tatimit në pronë e në veçanti arkëtimin e qirasë për shfrytëzimin e pronës së Komunës, të paktën unë jam në dijeni se në kontratën për shfrytëzim ceket që mos përmbushja e obligimeve në mes palëve kontraktuese është element për shpëputjen e kontratës. Në këtë kontekst shtrohet pyetje përse ne, të paktën, të mos e kemi në mënyrë publike listën e qiramarrësve të cilët e kanë marrë në shfrytëzim pronën e Komunës shumë kohë përpara dhe në kushte krejtësisht tjera më të favorshme për ta, e jo në kushte të tanishme që janë më të pafavorshme dhe sot e kësaj dite ngurrojnë dhe nuk i përmbushin obligimet ndaj Komunës. Lidhur me këtë kemi debatuar në mandatin e kaluar të Kuvendit dhe kemi arritur qëndrimin që t'iu shpëputet kontrata shfrytëzuesve të cilët nuk i kanë përmbushur obligimet ndaj Komunës dhe të fillohet procedura për dhënie në shfrytëzim të pronave përkatëse.

z. Kadri Avdiu, theksoi, nuk do t'i përsërisë çështjet të cilat i ngritën parafolësit por do të ndërlihem me atë ku u përmenden fshatrat Tërnavë dhe Halabak, lidhur me këtë jeni të informuar ngase gjatë debateve në mbledhje disa herë kam kërkuar llogari për punime që janë kryer në fshatrat e cekura pa u miratuar në Kuvend, jashtë çdo rregulle dhe jashtë çdo normative. Njëra prej rrugëve është përgatitur për asfaltim në vitin 2010, për çka nuk ka qenë asnjë cent i paraparë, pra qeverisja komunale ka lidhë kontratë private me operatorin.

Konsideroj se në këtë raport ka aq shumë vërejtje dhe habitem me kënaqësinë e drejtorit **z. Isuf Latifi** që e shprehu në fjalën hyrëse lidhur me këtë raport.

Ekzekutivi i Komunës duhet të respektoj ligjin dhe rregullat e jo të bartë mjete kur të dojë dhe kah të dojë.

U përmend se auditim të brendshëm nuk kemi pas asnjëherë, planë pune nuk kemi pas asnjëherë, pronat e Komunës nuk i menaxhojmë dhe nuk i kemi në mbikëqyrje dhe nuk janë të evidentuara.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, sa i përket mikpritjes së Auditorit të Përgjithshëm kjo ka të bëjë me atë që çdo dokument i kërkuar i është dorëzuar menjëherë brenda 5 apo 10 minutave. Përndryshe Auditori gjatë punës së tij në vende të ndryshme hasë në vështirësi në sigurimin e dokumenteve të ndryshme me arsyetim se dokumenti përkatës është te ky apo ai

zyrtar apo mungon zyrtari kompetent, pra falënderimi i Auditorit ka qenë në këtë kuptim.

Ky raport është rrumbullakim i aktiviteteve të një viti, sikur të marrim një vit mësimor dhe në fund komunikohet rezultati dhe nëse e marrim një nxënës dhe i thuhet se ka kaluar shkëlqyeshëm apo shumë mirë megjithatë i ke disa të meta të cilat mund t'i evitosh, pra në këtë aspekt unë kam shprehur kënaqësinë ngase Auditori ka thënë se e kemi opinionin më të lartë por megjithatë i kemi disa vërejtje. Krahastuar me raportin e vitit të kaluar që i kemi pas 15 rekomandime, këtë vit i kemi 10 rekomandime, pra tash i kemi 5 rekomandime më pak.

Regjistrimi i pasurive, Auditori nuk e ka fjalën se nuk janë regjistruar objektet e Komunës, ndonjë shkollë apo objekt i QMF-së por theksi është për pagesat e bëra në shumë mbi 400.000 € për asfaltimin e rrugëve, kanalizime, trotuare shpenzime të cilat nuk kanë mundur të regjistrohen brenda vitit përkatës.

Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve, këtë e kemi diskutuar edhe më parë por edhe Auditori e ka gjetur, jo që ne e kemi ndërruar pagesën, por fjala është për dy – tri pagesa sipas projekteve të miratuara në Kuvend që nuk janë klasifikuar në kode adekuate, e nganjëherë jemi të detyruar të veprojmë kështu për shkak të mungesës në kategoritë përkatëse, njëra prej atyre pagesave është blerja e lloptëve për këshilltarë të Kuvendit, pagesa për dezinfektim, derratizim dhe dezinfektim, projekt i cili gjithashtu ka qenë i miratuar, ndërsa rasti i tretë është pagesa për largimin e deponive të egra.

Sa i përket mos shpenzimit të të hyrave vetanake, e kam cekur edhe më parë dhe po e përsëris se është e pamundur që të shpenzoje të hyrat vetanake të arkëtuara në muajt nëntor dhe dhjetor të viteve përkatëse dhe atë për shkak se zotimet e mjeteve kapitale përfundojnë me 7 nëntor të çdo viti.

Sa i përket pagesave nuk është kompetencë e imja me hy në dosje të tenderit ngase kjo është kompetencë e tjetërkujt, por për mua është e rëndësishme kontrata, raporti i punës dhe dokumentacioni tjetër përcjellës i nevojshëm për ekzekutimin e pagesës.

Niveli i ulët i mos arkëtimit të qeras është për shkak se disa bizneseve të mëdha ju ka ndërprerë për shfrytëzim të mëtejshëm të pronave përkatës e të cilat kanë mbetur me obligime të mëdha ndaj Komunës e që rastet janë në procedurë gjyqësore.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, parafolësi foli për çështjen e pagesave, unë pajtohem me atë çfarë tha, por konsideroj se bëhen shkelje ligjore në format deri sa çështja vjen te pagesa.

Drejtori z. Isuf Latifi, kur e krahasoi këtë raport, mori shembull notimin e nxënësit, mirëpo unë konsideroj se në çdo fushë je në prioritet në kuadër të dhjetëshes së parë e të mirëve dhe atyre të këqijve, por në raport Komuna e jonë përfshihet në dhjetëshen e komunave me menaxhim të keq, konkretisht për trajtimin e borxheve.

Çështje tjetër shqetësuese është se nuk janë evidentuar pasurit deri në masën 1000 € e me këtë të njëjtat mund të humbin apo të tjetërsohen. Lidhur me këtë konsideroj se Komisioni përkatës apo dikush duhet të jep llogaridhënie. Po ashtu llogaridhënie duhet të jep edhe për çështjen e pronës në fshatin Sallabajë ku komisioni i ngritur nga Kuvendi i Komunës, për një ari, e ka caktuar shumën minimale 0.05 cent, kjo është banale dhe për këtë do të debatohet tjetër herë.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, Raporti i Auditorit të Përgjithshëm, marrë në përgjithësi është mjaftë i mirë me opinion pozitiv, kuptohet janë disa vërejtje të vogla të cilat në të ardhmen do të evitohen.

z. Naim Çunaku, theksoi, konstatimi i parafolësit është jo real dhe i gabuar ngase në raport, nga Auditori i Përgjithshëm, janë evidentuar lëshime dhe parregullsi të shumta.

4. Raporti financiar për periudhën janar – qershor 2014

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën e hyrjes.

z. Kadri Avdiu, theksoi, drejtori z. Isuf Latifi, në fjalën e hyrjes tha se krahasuar me vitet e mëparshme këtë vit pagesat për punët e kryera janë bërë afro 50%, pajtohem se ndoshta pagesat janë bërë deri në përqindjen e cekur, por unë jam në dijeni se ato pagesa janë bërë për punime të kryera vite më parë, andaj unë nuk mund të kuptoj si mund të bëhet pagesa për punime që janë kryer para dy viteve.

Pauzë 14,30' – 14,50'

Fillimisht u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

z. Haki Rudari, theksoi, përveç kodit të pagave dhe mëditjeve në kodet tjera vërehet përqindje e ulët e shpenzimeve.

Marrë në përgjithësi ky raport është hartuar mirë dhe janë paraqitur të dhënat relevante për periudhën e caktuar. Për më tepër opinionin tim do ta paraqes në mbledhjen e Kuvendit.

z. Naim Çunaku, theksoi, sa unë kam informacione Komuna aktualisht nuk ka operator për mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare, shtrohet pyetja si mund të ndodhë kjo kur dihet se para skadimit të afatit përkatës duhet të iniciohen procedurat për përzgjedhjen e operatorit sipas procedurave të parapara të prokurimit.

Për dezinfektim, derratizim dhe dezinfektim kanë qenë të parapara 20.000 € mirëpo asgjë nuk është ndërmarrë për lokalitetet e rrezikuara buzë shtratit të lumit Llap, çështje të cilën shumë herë e kam ngritur.

z. Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, theksoi, dezinfektimi, derratizimi dhe dezinfektimi është bërë sipas planifikimeve përkatësisht në institucionet arsimore, ato shëndetësore dhe institucionet tjera komunale si dhe në disa hapësira publike, mirëpo për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore nuk ka pas mundësi që DDD-ja të bëhet edhe në lokacionet që i përmendi parafolësi.

Pas votimit konstatohet se njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

5. Miratimi i propozimit të Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për kushtet e bllokimit dhe zhvendosjes së automjeteve

Pas votimit konstatohet se njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

- 6. Propozimi i vendimeve për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (Sipas kërkesave të Ejup Jasharit – Balloc dhe Hamit Hamitit – Reçicë dhe Muharrem Isufit nga fshati Majac)**

Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

- 7. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 01-119-61160, datë 18 korrik 2014, për kompensimin e punëve dhe angazhimeve të Komisionit për propozimin e emërtimeve të zonave, lagjeve urbane, shesheve, parqeve, rrugëve dhe rrugicave në territorin e Komunës së Podujevës**

Fillimisht gjatë shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, për shkak të konfliktit të interesit, nga mbledhja u larguan kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit për propozimin e emërtimeve të rrugëve, përkatësisht kryesuesi z. Mehmet Gashi dhe anëtarët e këtij Komiteti z. Kadri Avdiu dhe z. Naim Çunaku.

Vazhdimin e mbledhjes e kryesoi z. Mynavera Abdullahu – Krasniqi, e cila sqaroi se vendimi i cekur është miratuar në mbledhjen e kaluar të Kuvendit, por me atë rast kanë votuar edhe anëtarët e Komisionit të cekur e kjo paraqet konflikt interesi, arsye për të cilën Kryetari i Komunës, në formë të shkruar, ka kërkuar që ky vendim të rishqyrtohet në Kuvend.

Kuvendit, njëzëri i rekomandohet që vendimi të rishqyrtohet.

Vazhdimin e mbledhjes e kryesoi kryesuesi z. Mehmet Gashi.

- 8. Propozimi i vendimit për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim**

Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

9. Të ndryshme

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, njoftoi se në Komunën e Podujevës në vizitë është një delegacion i kryesuar nga Kryetari i Qytetit Westerstede – Gjermani.

z. Naim Çunaku, propozoi që delegacioni i Qytetit Westerstede të ftohet në një drekë në Orlan apo në ndonjë vend tjetër, drekë në të cilën do të ftoheshin edhe këshilltarët e Kuvendit të Komunës.

Mbledhja përfundoi në orën 15.05 '

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01- 006-79802
Podujevë,
30 korrik 2014**

**Kryesuesi i Komitetit
Mehmet Gashi**